

Çmimi vjetor për zyrtarin e dalluar komunal

KRITERET E PËRGJITHSHME

Përfshirje e qytetarëve në formulimin e politikave lokale (10 pikë)

- Të ketë përfshirë në mënyrë aktive qytetarët në proceset e vendimmarrjes përmes forumeve, konsultimeve ose metodave të tjera të pjesëmarrjes publike në nivelin lokal të qeverisjes
- Të ketë demonstruar përkushtim të vazhdueshëm për rritjen e përfshirjes së qytetarëve në proceset komunale përmes organizimit të takimeve të përbashkëta, takimeve individuale, komunikimin me këshillat lokal, komunikimin dhe bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile, organizatat e bizneseve, mediave si dhe akterëve tjerë relevantë

Transparenca dhe komunikimi i hapur (10 pikë):

- Mbajtja e komunikimit transparent për vendimet dhe aktivitetet e komunës
- Publikimi i informatave në kohë reale për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset konsultuese, takimet publike apo procesin e disajnit të politikave lokale
- Përdorim i rrugëve të qasshme të komunikimit me qëllim të shpërndarjes së informacionit dhe përditësimeve të nevojshme për publikun

Lidershipi në proceset e vendimmarrjes komunale (10 pikë):

- Të ketë treguar aftësi lidershipi në udhëheqjen e iniciativave komunale dhe vendimeve për politika lokale ku në mënyrë proaktive janë përfshirë edhe qytetarët
- Të ketë inkurajuar një qasje bashkëpunuese ndërmjet stafit komunal dhe qytetarëve, në procesin e disajnit të politikave lokale, proceset e konsultimeve publike si dhe procesin e planifikimit buxhetor

Gjithëpërfshirja (10 pikë):

- Të ketë siguruar që proceset e vendimmarrjes lokale të përfshijnë perspektivën e qytetarëve
- Të ketë siguruar përfshirjen e grave, komunitetet pakicë, të rinjtë dhe personave me aftësi të kufizuar, në proceset e disajnit të politikave lokale

Avancimi i mënyrave të angazhimit të qytetarëve përmes metodave inovative (10 pikë):

- Zbatimi i praktikave inovative të përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe procesin e planifikimeve buxhetore
- Zbatimi i metodave apo teknologjive inovative për të rritur angazhimin e qytetarëve

KRITERET E VEÇANTA

Vitet e shërbimit në administratën komunale (5 pikë)

- Të ketë shërbyer së paku 2 vjet në kuadër të administratës komunale (5 pikë shpërblehet zyrtari i cili ka 10 vite e më shumë përvojë)

Qasja proaktive për përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimarrëse në Komunë (15 pikë)

- Të përfshirë në mënyrë aktive qytetarët në proceset e vendimmarrjes përmes forumeve, konsultimeve apo takimeve duke përfshirë perspektivën e qytetarëve në politikat lokale, sipas një qasje të bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe komunës

Komunikimi transparent me qytetarët (10 pikë)

- Mbajtja e komunikimit transparent për aktivitetet e komunës përmes takimeve konsultuese me qytetarët, takimeve publike, konsultimet publike për politikat lokale, takime të rregullta me qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile, komunikim i rregullt elektronik përmes mediave sociale dhe mënyrave tjera të komunikimit online

Përgjegjshmëri e lartë në adresimin e çështjeve të Komunitetit (10 pikë)

- Adresimi i kërkesave të qytetarëve dhe zgjidhja e çështjeve të komunitetit, duke kontribuar që të tejkalohen sfidat dhe pengesat gjatë procesit të realizimit të kërkesave të tyre

Partneriteti me bizneset, shoqërinë civile, diversiteti dhe gjithëpërfshirja (10 pikë)

- Të ketë ndërtuar një partneritet dhe dialog të strukturuar me bizneset për të sjellë perspektivën e zhvillimit ekonomik lokal në politikat lokale
- Të ketë arritur një komunikim konstruktiv me organizatat e shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes lokale
- Të jetë angazhuar aktivisht që të përfshihen grupet tradicionalisht të nënreprezentuara (gratë, komunitetet pakicë, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara) në formulimin e politikave lokale dhe proceset vendimarrëse lokale